

FOTO/ Qëlloi me kallashnikov gjatë natës, arrestohet 30-vjeçari në Fier

14:38 11/06/2020

Share

f

t

in

o



f 76,586 Fansa PËLQEJE

Një 30- vjeçar nga Gorishova e Fierit ka rënë në prangat e policisë, pasi gjatë natës ka gjuajtur me kallashnikov.

Në një njoftim për mediat policia bën me dije se pas 13 orëve në pranga ka rënë një person me inicialet D.A, ndërsa u zbulua se ai kishte qenë i dehur kur kishte shtënë dhe nuk kishte lënduar njeri.

Pas të shtënave 30-vjeçari e kishte fshehur armën në pyll, megjithatë ajo u gjet dhe sekuestrua nga policia në cilësinë e provës materiale.

Njoftimi i policisë:

Fier- Policia zbardh ngjarjen e ndodhur në orët e para të datës 11.06.2020 në fshatin Gorishovë.

Kapet dhe arrestohet në flagrancë personi që gjuajti në ajër me armë zjarri.

Sekuestrohet arma me të cilën ka gjuajtur autori.

Sot, rreth orës 01:00, është marrë njoftim se në fshatin Gorishovë janë dëgjuar të shtëna me armë zjarri.

Nga të shtënat nuk ka pasur persona të lënduar.

Menjëherë, në fshatin Gorishovë, kanë shkuar shërbimet e Policisë, të cilët falë veprimeve të shpejta operationale bënë të mundur kapjen dhe arrestimin në flagrancë të autorit të dyshuar, shtetasit D. A., 30 vjeç, banues në Gorishovë, i cili dyshohet se ka qenë në gjendje të dehur.

Në cilësinë e provës materiale u sekuestrua arma tip kallashnikov, të cilën 30-vjeçari e kishte fshehur në pyll.

Materialet do t'i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, për veprime të mëtejshme procedurale.ka.ta/Fjala.al/

Policia e Shtetit
on Thursday



Fier- Policia zbardh ngjarjen e ndodhur në orët e para të datës 11.06.2020 në fshatin Gorishovë.
Kapet dhe arrestohet në flagrancë personi që gjuajti në ajër me armë zjarri.
Sekuestrohet arma me të cilën ka gjuajtur autori.... See More

157	2	1
-----	---	---

Like Share 80 people like this. Sign Up to see what your friends like.

ETIKETA arrestim fier kallashnikov nate

Share f t in o

Lajme të tjera



Nga vjedhja te dhuna në familje, arrestohen 5 persona në Tiranë

Kronikë | 13:39 12/06/2020



Kundërshtoi dhe goditi efektivin e policisë, arrestohet 26-vjeçari në Tiranë

Kronikë | 10:49 12/06/2020



Ktheu shtëpinë në laborator droge, pranga pronarit, më parë iu kap gruaja e i biri

Kronikë | 10:16 12/06/2020



Iu gjet granatë me vete, arrestohet 57-vjeçari në Elbasan

Kronikë | 09:19 12/06/2020

Web TV



Spartak Ngjela për “Fjala”: Partitë e mëdha nuk i lejojnë zgjedhjet...

07:20 10/06/2020



Momenti kur avioni me pasagjerë goditet nga rrufetë

19:52 08/06/2020



Artan Fuga posaçërisht për “Fjala”: Të mos jetë revolta e mamave!

09:40 06/06/2020

Fjala është e lirë. Liria është fuqi!

E-mail : info@fjala.al

FJALA MEDIA GROUP
NUIS/NIPT : L92423005H

Na ndiqni në

f Facebook

Instagram

Youtube